




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I **INDUSTRIË KIMIKE**





PROFILI I INDUSTRIISË KIMIKE

Mirënjohje

Ky raport është financuar nga Ministria për Punë të Jashtme të Finlandës në kuadër të projektit “Ndihmë Tregtisë”, që zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Autor:

Visar Vokrri

Anketa është realizuar nga UBO Consulting

Sigurimi i cilësisë i ofruar nga:

Departamenti i Industrisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ekipi i projektit “Ndihmë Tregtisë” UNDP

Faqosja:

Studio “InDesign”, Prishtinë

Një mirënjohje e veçantë u takon të gjithë të anketuarve të këtij studimi.

Ky dokument nuk ka të drejtë autoriale prandaj përmbajtja e tij mund të përdoret pjesërisht ose plotësisht pa lejen paraprake të UNDP-së. Mirëpo, burimi i saj, duhet të citohet.

Pikëveshtrimet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe të Ministrisë për Punë të Jashtme të Finlandës.

Përmbajtja

Mirënjohje.....	3
1. Hyrje.....	6
2. Karakteristikat bazë të kompanive dhe industrisë.....	7
2.1 Madhësia dhe përbërja e industrisë kimike.....	7
2.2 Madhësia dhe vendndodhja gjeografike e kompanive.....	9
2.3 Pronësia e kompanive të intervistuar.....	10
3. Prodhimi.....	13
3.1 Faktorët e prodhimit.....	13
3.2 Prodhimi.....	14
3.3 Shfrytëzimi i kapacitetit.....	15
4. Tregjet, eksportet dhe barrierat për eksport.....	17
4.1 Qarkullimi në industri.....	17
4.2 Tregu vendorë.....	18
4.3 Tregu i eksportit.....	19
4.4 Barrierat për eksport.....	23
5. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore.....	25
5.1 Punësimi dhe struktura demografike e punonjësve.....	25
5.2 Aftësitë e fuqisë punëtore.....	27
6. Asetet, investimet dhe inovacioni.....	29
6.1 Asetet.....	29
6.2 Investimi dhe inovacioni.....	30
7. Mjedi i biznesit.....	33
7.1 Barrierat në zhvillimin e biznesit: perceptimet biznesore.....	33
Konkludimet.....	37
Referencat.....	39



1. Hyrje

Ky profil ofron një vështrim të gjendjes aktuale të industrisë kimike në Kosovë. Përveç kësaj, ky profil pasqyron zhvillimet dhe trendet e kohëve të fundit në këtë industri. Karakteristikat bazë janë marrë kryesisht nga të dhëna sekondare si statistikat zyrtare të publikuara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK). Për më tepër, ky profil përshkruan performancën e kësaj industrie duke përdorur të dhëna nga hulumtimi i ndërmarrjeve i realizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) gjatë periudhës tetor – nëntor 2015. Mostra për këtë hulumtim përbëhet nga 40 firma nga gjithsej 122 sosh të regjistruara në bazën e të dhënave të ATK-së sipas kodeve 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2030, 2041, 2052, 2053, 2059, dhe 2060 të Nomenclature des Activités Économiques dans la Communauté Européenne (NACE).^{1, 2} Duhet theksuar që kompanitë e angazhuara në prodhimin e produkteve bazike farmaceutike si dhe preparateve farmaceutike nuk janë përfshirë pasi që produktet farmaceutike konsiderohen si sektor i ndarë sipas Versionit 2 të rishikuar të NACE.³

Për qëllime të kësaj analize, aktivitetet kryesore në këtë industri, sipas të dhënave nga hulumtimi do të përkufizohen si në vijim: (i) Prodhimi i ngjyrave, llaqeve e shtresave të ngjashme, ngjyrës për printim dhe rrëshirës, (ii) Prodhimi i sapunit dhe detergjenteve, preparateve për pastrim dhe lustrim, dhe (iii) Prodhimi i ngjitësve.

Analiza tregon që industria kimike është një industri gjithnjë në rritje në Kosovë, si për nga aspekti i shitjeve ashtu edhe nga aspekti i punësimit. Gjysma e kompanive aktuale janë krijuar para pak më shumë se tri vitesh, e që janë të përqendruara kryesisht në rajonin e Prishtinës. Shumica dërmuese e kompanive kanë filluar të eksportojnë pas vitit 2010. Aktualisht, më pak se një e treta e kompanive janë të angazhuara në aktivitete eksportuese, ku në shitjet e përgjithshme eksporti paraqet një pjesë simbolike. Dallimi ndërmjet importit dhe eksportit të produkteve kimike në Kosovë është i lartë; vetëm 3% e importeve të përgjithshme janë mbuluar nga i gjithë eksporti në tre tremujorët e parë të vitit 2015.

Kjo analizë është e organizuar në tetë pjesë të ndryshme. Një hyrje e shkurtë dhe metodologjia e studimit janë shtjelluar në pjesën e parë. Pjesa e dytë shtjellon karakteristikat bazë të industrisë kimike. Pjesa e tretë ofron një vështrim të performancës aktuale të kompanive dhe shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre. Analiza e tregjeve, punësimit dhe shkathtësive të fuqisë punëtore janë paraqitur në pjesën e katërt, respektivisht të pestë. Vlerësimi i strukturës dhe vlerës së aseteve si dhe investimeve në inovacion janë paraqitur në pjesën e gjashtë. Pjesa e shtatë analizon barrierat e përceptuara për zhvillim të bizneseve në industrinë kimike në Kosovë. Pjesa e fundit ofron konkludimet.

1 NACE Rev. 2 në dispozicion në: http://www.arbk.org/repository/docs/NACE_Rev_2_ENG_513445.pdf

2 Mostra fillestare e kalkuluar në 95% nivel besueshmërie dhe interval besueshmërie prej 7% përmbante 75 kompani në këtë industri. Sidoqoftë, rreth 35 ishin përjashtuar nga hulumtimi pasi që ato kompani kishin raportuar se kishin ndryshuar aktivitetet e tyre primare apo kishin kaluar në industri/sectorë tjerë.


3 http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL&StrNom=NACE_REV2&StrLanguageCode=EN&IntPcKey=18496334&StrLayoutCode=

2. Karakteristikat bazë të kompanive dhe industrisë

2.1. Madhësia dhe përbërja e industrisë kimike

Edhe pse sipas bazës së të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), industria kimike numëron 122 kompani të regjistruara, jo të gjitha këto kompani operojnë në këtë industri pasi disa nga to tashmë i kanë ndryshuar aktivitetet e tyre primare. Shumica e kompanive në këtë industri janë biznese individuale (rreth 51%); të pasuara nga Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar (rreth 43%). Partneritetet e përgjithshme, kompanitë e huaja dhe ndërmarrjet shoqërore, secila nga to përbën rreth 2% të bizneseve aktive në industrinë kimike.


Figura 1: Struktura e kompanive



Burimi: ATK (2015)

Sipas të dhënave të njëjta, 103 kompani, apo 84%, janë ndërmarrje mikro, me 1-9 punonjës; 17 apo 14% janë ndërmarrje të vogla (me 10-49 punonjës) dhe 2 të fundit, afërsisht 2%, janë ndërmarrje të mesme.


Figura 2: Madhësia e kompanive në industrinë kimike



Burimi: ATK (2015)

Pothuajse gjysma e kompanive aktuale janë krijuar kryesisht gjatë tri viteve të fundit. Sipas ARBK-së, gjatë periudhës 2012-2015, në industrinë kimike janë krijuar gjithsej 65 biznese të reja. Nga ky numër, 54% të kompanive janë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK); 40% janë biznese individuale; 3% janë partneritete të përgjithshme dhe 3% janë kompani të huaja.

Figura 3: Struktura e kompanive të sapokrijuara në periudhën 2012-2015




Burimi: ARBK (2015)

Bazuar në kodet e klasifikimit NACE, 33% e ndërmarrjeve të sapokrijuara operojnë në "Prodhimin e sapunit dhe detergjenteve, preparateve për pastrim dhe lustrim (kodi 2041); 14% në "Prodhimin e ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrës për printim dhe rrëshirave (kodi 2030)"; 14% në "Prodhimin e ngjyruessve dhe pigmenteve" (kodi 2012) dhe 6% në "Prodhimin e plehrave artificiale dhe komponimeve të azotit (kodi 2015)".

2.2 Madhësia dhe vendndodhja gjeografike e kompanive

Sipas bazës së të dhënave të ATK-së, shumica e ndërmarrjeve ndodhen në rajonin e Prishtinës (rreth 32% prej tyre); të pasuara nga rajoni i Prizrenit (20%), i Ferizajt (17%) e kështu me radhë.


Figura 4: Vendndodhja gjeografike e kompanive në industrinë kimike



Burimi: ATK (2015)

Shpërndarje e ngjashme gjeografike është evidente gjithashtu tek ndërmarrjet e reja. Sipas ARBK-së, shumica e kompanive të reja janë regjistruar në rajonin e Prishtinës (rreth 36%) – kryesisht në komunat Fushë Kosovë dhe Obiliq. Rajoni i Ferizajt është i dyti, me afërsisht 25% të bizneseve; Mitrovica e treta me 16%, Peja dhe Prizreni të dyja me nga 10%, ndërsa Gjakova mbetet e fundit me vetëm 3%.

Figura 5: Vendndodhja gjeografike e kompanive të sapokrijuara




Burimi: ARBK, 2015

2.3. Pronësia e kompanive të intervistuar

Sipas Figurës 6, shumica e kompanive (72.5%) janë të regjistruara si biznese individuale – këto zakonisht janë biznese që janë në pronësi dhe udhëhiqen nga një individ dhe në të cilat nuk ka dallim ligjor ndërmjet pronarit dhe biznesit. Grupi i dytë më i madh, (20%) përbëhen nga Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar. Vetëm dy nga kompanitë e anketuara (5%) ishin partneritete të përgjithshme; ndërkaq vetëm një kompani (2.5%) ishte shoqëri aksionare.


Figura 6: Struktura organizative e kompanive të intervistuar



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Mosha mesatare e pronarëve është 45 vjeç; dhe 99% e kompanive të intervistuar janë në pronësi të shqiptarëve. Kompanitë në pronësi të grave përbëjnë vetëm 8% të numrit të përgjithshëm të kompanive të anketuara. Figura 7 ilustron pronësinë sipas grupmoshave.


Figura 7: Pronësia e kompanive sipas grupmoshave



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Figura në vijim paraqet nivelin arsimor të pronarëve, ku rreth 47%, kanë të përfunduar arsimin e mesëm, 45% nivelin terciar dhe vetëm 8% janë me arsim fillor.

Figura 8: *Niveli arsimor i pronarëve*



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kutiza 1: Profili i një biznesi të suksesshëm që operon në Kosovë

E vendosur në Mitrovicë, **Eco Color**, është një prej kompanive më të suksesshme dhe më moderne në industrinë kimike në Kosovë. Kjo kompani është themeluar në vitin 2008 dhe aktualisht ofron një gamë të gjerë të ngjyrave dhe llaqeve e fasadave, kryesisht për sektorin e ndërtimtarisë. Ka filluar si një nismë e tre ndërmarrësve entuziast me përvojë të gjatë në këtë industri.

Pas disa viteve të suksesshme, Eco Color ka tërhequr prodhuesit e mirënjohur evropian që ishin të interesuar të futeshin në tregun e Kosovës. Në vitin 2014, një prej kompanive më të mëdha në industrinë kimike në Itali, **Gruppo Ivas**, u bë aksionari i katër i Eco Color. Gruppo Ivas është kompani e specializuar me më shumë se gjashtëdhjetë vite përvojë në prodhimin e ngjyrave, llaqeve, shtresave tjera, dhe fasadave të ndryshme që përmbushin kërkesat më komplekse të dizajnit dhe ndërtimit të klientëve në tregun Evropian.

Me partnerin e ri tanimë pjesë të ekipit, kompania kohëve të fundit ka investuar në objektin e ri me pajisje dhe teknologji të dorës së fundit. Kompania aktualisht punëson 14 punonjës me orar të plotë dhe pesë punonjës sezonal. Sidoqoftë, linja e re e prodhimit që pritet të vihet në funksion gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, do të dyfishojë numrin e punonjësve.

Eco Color prodhon produktet e saj duke përdorur teknologjinë dhe ekspertizën e partnerit italian, gjë që e bën këtë kompani prodhuesin e parë në Kosovë që përmbushë standardet ndërkombëtare për produkte eficiente në energji. Produktet e tilla janë kryesisht të pranishme në tregun vendor; vetëm 5% e prodhimit të përgjithshëm të kompanisë eksportohet në tregun rajonal, kryesisht në Shqipëri. Në anën tjetër, lënda e parë dhe faktorët e ndërmjetëm të prodhimit importohen ekskluzivisht nga tregu i BE-së, konkretisht nga Italia dhe Gjermania.

Shitësit vendorë me shumicë përbëjnë 90% të konsumatorëve të kompanisë; pjesa tjetër prej 10% janë kryesisht kompani ndërtimore në Kosovë. Për shkak të investimeve të vazhdueshme në objektet e sapondërtuara, kompania aktualisht është duke shfrytëzuar vetëm 50% të kapaciteteve të saj të instaluar prej 30 ton/ditë. Sidoqoftë, menaxhmenti është i vendosur që të shfrytëzojë plotësisht kapacitetet e kompanisë dhe të zgjerojë edhe më tej gamën e produkteve gjatë vitit në vijim.

Kompania i konsideron politikat fiskale të Kosovës si një prej pengesave kryesore në operimet e tyre biznesore. Sipas menaxhmentit të kompanisë, taksat doganore mbesin të aplikueshme për pothuajse të gjithë lëndën e parë që përdoret për prodhimin e ngjyrave dhe llaqeve.

3. Prodhimi

3.1. Faktorët e prodhimit⁴

Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se lëndët e para dhe produktet e ndërmjetm të prodhimit përbëjnë pjesën më të madhe të kostos së prodhimit për kompanitë mikro dhe të vogla në industrinë kimike, 74% respektivisht 68% e kostos së përgjithshme. Në anën tjetër, raporti i kostove për paga me koston e përgjithshme të faktorëve të prodhimit është 20% për të dyja grupet – kompanitë mikro dhe të vogla. Kostoja mesatare mujore e faktorëve të prodhimit në nivel sektori për lëndë të parë, produkte të ndërmjetme të prodhimit dhe paga është afërsisht 29,000 Euro (Tabela 1).

Tabela 1: Kostoja mesatare e faktorëve të prodhimit varësisht nga madhësia e kompanisë në EUR

Faktorët e prodhimit	Lënda e parë dhe produktet e ndërmjetm	Pagat	Energjia elektrike	Uji	Karburanti	Tjera
Madhësia e kompanisë						
Mikro (≤9 punonjës)	14,705	3,961	210	34	416	550
E vogël (10 - 49 punonjës)	29,974	8,861	1,284	86	3,472	185
Mesatarja e sektorit	22,496	6,286	720	59	1,868	307

Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Vlen të theksohet se shumica e lëndës së parë dhe faktorëve të ndërmjetm që përdoren nga kompanitë kosovare në këtë industri importohen; pothuajse dy të tretat e kompanive të anketuara kanë raportuar se faktorët e sipërpërmendur janë ekskluzivisht të importuar, kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian (BE) si dhe nga shtetet anëtare të Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Një e pesta e kompanive furnizohen me lëndë të parë dhe faktorë të ndërmjetm nga tregtarë vendorë, ndërkaj pothuajse 13% e tyre furnizohen drejtpërdrejt nga prodhues të huaj. Përveç kësaj, 25% e kompanive kanë deklaruar që përdorin lëndë të parë dhe produkte të ndërmjetme të prodhuara në vend dhe poashtu të importuara. Në fund, siç edhe do të pritej, vetëm 10% e kompanive mbështeten në furnizime vendore, nga prodhimi vetjak apo furnizuesit tjerë vendorë (Tabela 2).

Tabela 2: Struktura e lëndës së parë dhe produkteve të ndërmjetme

Burimi	Pjesëmarrja e kompanive
Ekskluzivisht të prodhuara në vend	10 %
Prodhim i brendshëm	6.0 %
Prodhues vendorë	4.0 %
Përzierje e prodhimeve vendore dhe të importuara	25 %
Ekskluzivisht të importuara	65 %
Tregtarë vendorë	20.0 %
Tregtarë ndërkombëtarë	5.0 %
Prodhues të huaj (drejtpërdrejt)	12.5 %
Importe të përziera	27.5 %


4 Në anglisht: inputs.

Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

3.2. Prodhimi⁵

Edhe pse prodhimi i raportuar i kompanive dallon nëpër nën-sektorë, vlera mesatare e prodhimit të përgjithshëm në nivel të industrisë në vitin 2014 ishte rreth 583,000 Euro (484,000 Euro në vitin 2013). Prodhimi vjetor i raportuar i të gjitha kompanive që aktualisht prodhojnë lloje të ndryshme të ngjitësve dhe materialeve lidhëse (që kryesisht përdoren në sektorin e ndërtimitarisë), ishte më shumë se 25,000 Euro në vitin 2014. Në anën tjetër, 57% e prodhuesve të sapunit dhe të detergjentit, respektivisht 58% e prodhuesve të ngjyrave, llaqeve, dhe ngjyrës për printim, kanë raportuar prodhim vjetor mbi 50,000 Euro për vitin 2014 (Figura 9). Megjithatë, këto rezultate duhen interpretuar me kujdes pasi që vetëm një numër i vogël i kompanive kanë raportuar prodhimin e tyre vjetor.


Figura 9: Vlera vjetore e prodhimit sipas aktivitetit të kompanisë në EUR (2013)



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

⁵ Në anglisht: output.

Figura 10: Vlera vjetore e prodhimit sipas aktivitetit të kompanisë në EUR (2014)



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015)

3.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve

Niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve në nivel sektori është përmirësuar lehtë në vitin 2014 krahasuar me vitin paraprak. Niveli mesatar i shfrytëzimit të kapaciteteve në industrinë kimike ishte 61% në vitin 2013 dhe 65% në vitin 2014. Në vitin 2014, vetëm 10% e kompanive kanë shfrytëzuar plotësisht kapacitetet e tyre, ndërkohë që më shumë se 70% i kanë shfrytëzuar kapacitetet e tyre ndërmjet 60% e 100%. Vlen të përmendet që pjesa e kompanive që kanë shfrytëzuar kapacitetet e tyre më pak se 20% ka rënë nga pothuajse 13% në vitin 2013 në më pak se 3% të të gjitha kompanive të anketuara në vitin 2014 (Tabela 3).

Tabela 3: Shfrytëzimi i kapaciteteve (2013 dhe 2014)

Shfrytëzimi i kapacitetit	Pjesëmarrja e kompanive	
	2013	2014
Më pak se 20%	12.50%	2.50%
20% - 39%	5.00%	15.00%
40% - 59%	10.00%	10.00%
60% - 79%	40.00%	35.00%
80% - 100%	32.50%	37.50%
Total	100%	100%

Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kur bëhet fjalë për shfrytëzimin e kapaciteteve nga kompanitë që operojnë në industrinë kimike, nuk ka dallime të mëdha nëpër nën-sektorë. Prodhuesit e ngjitësve dhe materialeve lidhëse kanë arritur që të shfrytëzojnë mesatarisht 79% të kapaciteteve të tyre në vitin 2013 dhe 81% në vitin 2014. Gjatë periudhës 2013-2014, niveli i shfrytëzimit të kapacitetit sillet prej 50% deri në 69% në nën-sektorin e prodhimit të ngjyrave, llaqeve dhe ngjyrës për printim, respektivisht në nën-sektorin e prodhimit të sapunit dhe detergjenteve tjera (Tabela 4 paneli A).

Ngjashëm, dallimi në shfrytëzimin e kapaciteteve ndërmjet kompanive të madhësive të ndryshme është mjaft i vogël. Niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve është pak më i lartë tek kompanitë e vogla, krahasuar me ato mikro, 67% respektivisht 64% në vitin 2014 (Tabela 4 Paneli A dhe B).

Tabela 4: Dallimet në shfrytëzimin e kapacitetit

A: Shfrytëzimi mesatar i kapacitetit sipas sektorit

Shfrytëzimi i kapacitetit	Pjesëmarrja (%)	
	2013	2014
Prodhimi i ngjyrave, llaqeve e shtresave të ngjashme, ngjyrës për printim dhe rrëshirës	50%	56%
Prodhimi i sapunit dhe detergjenteve, preparateve për pastrim dhe lustrim	65%	69%
Prodhimi i ngjitësve dhe materialeve lidhëse	79%	81%
Mesatarja	61%	65%

Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

B: Shfrytëzimi mesatar i kapacitetit sipas madhësisë së kompanisë

Shfrytëzimi i kapacitetit	Pjesëmarrja(%)	
	2013	2014
Mikro (≤9 punonjës)	56%	64%
E vogël (10-49 punonjës)	66%	67%
Mesatarja	61%	65%


Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

4. Tregjet, eksportet dhe barrierat për eksport

4.1. Qarkullimi në industri

Vlera mesatare e shitjeve të raportuara në nivel sektori në vitin 2014 ishte rreth 376,290 Euro (367,900 në vitin 2013). Siç shihet nga figura e mëposhtme, shitjet e raportuara ndryshojnë nëpër nën-sektorë. Shitjet vjetore të raportuara të 43% të kompanive që aktualisht prodhojnë lloje të ndryshme të ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ishte më shumë se 50,000 Euro në vitin 2013. Në anën tjetër, 16% e prodhuesve të sapunit dhe detergjenteve tjera, respektivisht 25% e prodhuesve të ngjitësit dhe materialeve lidhëse kanë raportuar shitje vjetore mbi 50,000 Euro për vitin 2013 (Figura 11).


Figura 11: Vlera e shitjeve vjetore sipas aktivitetit të kompanisë në EUR (2013)



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Në anën tjetër, për vitin 2014, shitjet e raportuara vjetore tregojnë një trend në rritje. Rreth 57% e kompanive që prodhojnë ngjyra, llaqe dhe shtresa të ngjashme, kanë raportuar shitje vjetore më të larta se 50,000 Euro (43% në vitin 2013), respektivisht 38% e prodhuesve të ngjitësit dhe materialeve lidhëse kanë raportuar shitje vjetore mbi 50,000 Euro (25% në vitin 2013). Në anën tjetër, njëjtë sikur vitin paraprak, 16% e prodhuesve të sapunit dhe detergjenteve tjera kanë raportuar shitje mbi 50,000 Euro (Figura 12).

Figura 12: Vlera e shitjeve vjetore sipas aktivitetit të kompanisë në EUR (2014)




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

4.2. Tregu vendor

Produktet apo shërbimet finale përbëjnë shumicën e shitjeve në industrinë kimike, ndërsa produktet apo shërbimet e ndërmjetme ofrohen nga 7% e kompanive, dhe lënda e parë nga vetëm 3% e kompanive. Rreth 70% e kompanive të anketuara kanë shitur produktet e tyre në tërësi në tregun vendor gjatë vitit 2014.

Shumica e kompanive që shesin në tregun vendor, në vitin 2014 u kanë shitur produktet dhe shërbimet e tyre shitësve me shumicë, shitësve me pakicë apo konsumatorëve final. Në anën tjetër, tregtimi i tyre me kompanitë tjera përpunuese duket se ndodhë në intensitet më të ulët, pasi që vetëm rreth 13% të kompanive të industrisë kimike kanë shitur produktet e tyre tek kompanitë përpunuese në vitin 2014. (Figura 13).

Figura 13: Pjesa e shitjeve në tregun vendorë nga kanalet e tregut – blerësit




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

4.3. Tregu i eksportit

Sipas të dhënave zyrtare nga doganat, eksportet e përgjithshme të prodhuesve në industrinë kimike në Kosovë janë rritur në mes viteve 2013 dhe 2015, edhe pse në një vlerë shumë të ulët, duke arritur 4.84 milion Euro në 9 muajt e parë të vitit 2015 (Figura 14). Pjesa e eksporteve në importet e gjithëmbarshe në vitin 2015 ka arritur 3%, që ende është mjaft e vogël krahasuar me importet.


Figura 14: Eksportet e industrisë kimike (janar 2013 – shtator 2015)



Burimi: Doganat e Kosovës, 2015

Në anën tjetër, ndryshe nga trendi i eksportit, vlera e importeve në industrinë kimike duket se ka rënë në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2015. Nga rreth 221 milion Euro të importuara në vitin 2013, ka pasur një rënie të lehtë në vitin 2014 (209 milion Euro), ndërsa prej janarit deri në shtator 2015, vlera e importit në këtë sektor ka arritur vetëm në 138 milion Euro (Figura 15).

Figura 15: Importet në industrinë kimike (janar 2013 – shtator 2015)



Burimi: Doganat e Kosovës, 2015

Në përputhje me të dhënat zyrtare të doganave, të dhënat nga hulumtimi tregojnë rritje të konsiderueshme të kompanive eksportuese në industrinë kimike në vitin 2014, që përbëjnë 30% të numrit të përgjithshëm të kompanive, krahasuar me 18% të kompanive eksportuese në vitin 2013 (Tabela 5). Duke ndjekur trend të ngjashëm, intensiteti i eksportit, i matur si pjesëmarrje mesatare e shitjeve në eksport në qarkullimin e përgjithshëm, është rritur në 20% në vitin 2014, krahasuar me 19% në vitin 2013. Vlera mesatare e shitjeve për eksport në vitin 2013 ishte rreth 34,850 Euro, ndërsa në vitin 2014 ishte rritur lehtë në 35,600 Euro. Rreth 75% e kompanive eksportuese në vitin 2014 duket të jenë biznese të vogla, ndërsa pjesa tjetër prej 25% janë mikro biznese. Shumica e kompanive të anketuara kanë filluar të eksportojnë vetëm pas vitit 2010, gjë që tregon një fazë të hershme të krijimit dhe zhvillimit të lidhjeve me tregjet e huaja.


Tabela 5: Përqindja e kompanive eksportuese dhe pjesëmarrja mesatare e shitjeve për eksport në qarkullimin e përgjithshëm

	2013	2014
Përqindja e kompanive eksportuese në sektor	18%	30%
Pjesëmarrja mesatare e shitjeve për eksport në qarkullimin e përgjithshëm	19%	20%

Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Siç shihet në Figurën 16, përqindja më e madhe e eksportuesve është raportuar nga prodhuesit e sapunit dhe detergjenteve, preparatet për pastrim e lustrim, me rreth 50% të kompanive eksportuese në vitin 2014 (25% në vitin 2013). Një trend pozitiv është vërejtur edhe për prodhuesit e ngjitësit dhe materialeve lidhëse (25% në vitin 2014), ndërkah për prodhuesit e ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrës për printim dhe rrëshirave, përqindja e kompanive eksportuese ka rënë në 21% në vitin 2014 krahasuar me 28% në vitin 2013.


Figura 16: Përqindja e kompanive eksportuese sipas aktivitetit



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Të gjitha kompanitë eksportuese kanë raportuar se kanë eksportuar produktet e tyre finale gjatë vitit 2014, ndërsa vetëm 8% e tyre kanë eksportuar produkte të ndërmjetme. Kur janë pyetur për kanalet e tyre të eksportit, shumica e kompanive apo 58% e tyre kanë raportuar se përdorin distributorë me shumicë, rreth 25% përdorin tregtues me pakicë si mënyrë e arritjes tek konsumatori final, ndërsa vetëm 8% eksportojnë tek kompani tjera përpunuese (Figura 17).

Figura 17: Kanalet e tregut të eksportit – blerësit



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Produktet kryesore të eksportuara ishin detergjentet, ngjitësit dhe materialet lidhëse. Destinacionet kryesore për produktet e industrisë kimike janë Shqipëria, Gjermania dhe Turqia. Destinacionet me perspektivë të mirë për eksport përfshijnë vendet Evropiane dhe Ballkanike, siç janë Belgjika, Zvicra, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia.


Kutiza 2: Rregulloret tregtare dhe marrëveshjet për tregti të lirë

Kosova ka normë të përgjithshme të sheshtë prej 10% për importe dhe 0% për eksporte. Për importin e teknologjisë apo të produkteve të ndërmjetme që më pas ri-eksportohen (pas përpunimit) nuk aplikohen taksa doganore. Që nga viti 2014, është aprovuar Ligji Nr. 04/L-163 për Mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, sipas të cilit disa faktorë të prodhimit për industri kimike (siç janë pigmentet dhe materiet tjera për ngjyrosje, përzierjet e substancave aromatike, etj.) trajtohen si produkte me tarifë zero të tatimit doganor.

Kosova është anëtare e CEFTA-s dhe gëzon qasje pa taksa doganore në Bashkimin Evropian sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe në SHBA sipas Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (GSP). Kosova gjithashtu ka nënshkruar marrëveshjen për tregti të lirë me Turqinë, por kjo nuk ka hyrë në fuqi ende. Përveç kësaj, Kosova përfiton nga preferencat tregtare me Japoninë dhe Norvegjinë të cilat përfshijnë vetëm disa kufizime.

Sa i përket eksportit, rreth 29% e kompanive që nuk eksportojnë kanë bërë të ditur se kanë plane që të eksportojnë në të ardhmen, 43% do të donin të eksportonin, por konsiderojnë se do të ballafaqohen me shumë pengesa, ndërsa pjesa tjetër nuk kanë qëllim të eksportojnë fare (Figura 18).

Figura 18: Arsyet pse ata që nuk eksportojnë nuk shesin në tregjet e huaja




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

4.4. Barrierat për eksport

Nga kompanitë e hulumtuara ishte kërkuar që të rendisin barrierën e parë dhe të dytë në eksportim. Gjetjet tregojnë se procedurat doganore dhe standardet ndërkombëtare të cilësisë kryesisht konsiderohen si barriera kryesore e parë për eksportim, ndërsa mundësitë e kufizuara për të krijuar lidhje me blerës ndërkombëtarë dhe kostot e transportit konsiderohen si barriera kryesore e dytë për eksportim (Figura 19). Rreth 63% e kompanive të anketuara nuk kanë mundur të thonë barrierën kryesore të parë, respektivisht 52.5% kur janë pyetur për barrierën kryesore të dytë për eksportim.

Figura 19: Barrierat kryesore të para dhe të dyta për eksport



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kutiza 3: Dokumentet që kërkohen për tregtim ndërkufitar

Dokumentet që kërkohen për eksport:


- Dokumenti Unik Administrativ (d.m.th. deklarata doganore)
- Fatura komerciale

Dokumentet që kërkohen për import:

- Dokumenti Unik Administrativ (d.m.th. deklarata doganore)
- Fatura komerciale
- Certifikata e prejardhjes (për shtetet me të cilat Kosova ka tregti të lirë apo marrëveshje të tjera që mbulojnë përjashtimet bazuar në rregullat e prejardhjes).

Nga kompanitë e anketuara gjithashtu ishte kërkuar që të vlerësojnë në shkallën nga 0 deri në 10 – ku 0 paraqet vlerën minimale, ndërsa 10 vlerën maksimale – nëse një çështje e caktuar ka paraqitur pengesë apo barrierë që ata të eksportojnë. Pikët mesatare për secilën nga çështjet janë paraqitur në formë grafike në Figurën 20.

Figura 20: Barrierat për eksportim (pikët mesatare)



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Të dhënat tregojnë që pengesat më të mëdha në eksportim janë procedurat doganore, mungesa e financave dhe kostoja e lartë e garancive bankare. Në të njëjtën mënyrë – me gjithë investimet e bëra në infrastrukturë, kryesisht në ndërtimin e autostradës drejt Shqipërisë dhe kohëve të fundit drejt Maqedonisë – kostot e transportit shihen si faktori i katërt që pengon kompanitë nga ky sektor që të eksportojnë. Në anën tjetër, infrastruktura në vendet transite apo ato importuese shihet si pengesa më e vogël për eksportim.


Ndër pengesat tjera shtesë, kompanitë në industrinë kimike i konsiderojnë gjithashtu si barrierë të konsiderueshme në eksport pamundësinë për të ofruar trajnime për punonjësit e tyre dhe pamundësinë për të tregtuar apo plasuar me efikasitet produktet në treg.

5. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore

5.1. Punësimi dhe struktura demografike e punonjësve

Bazuar në statistikat zyrtare të publikuara nga ATK-ja dhe ASK-ja, në vitin 2014 industria kimike paraqiste vetëm 0.2% të të gjithë punonjësve të regjistruar në Kosovë.⁶ Sidoqoftë, të dhënat nga hulumtimi tregojnë që numri i punonjësve në këtë sektor është duke u rritur vazhdimisht. Aktualisht, numri i përgjithshëm i punonjësve në kompanitë e anketuara është 23% më i lartë sesa në vitin 2014. Prodhuesit e ngjitësit dhe materialeve lidhëse kanë përjetuar rritjen më të lartë sa i përket punësimit. Kompanitë e tilla kanë rritur mesatarisht numrin e punonjësve të tyre me 31% këtë vit pasuar nga nën-sektori i prodhimit të ngjyrave dhe ngjyrave për printim me 21% (Figura 21).

Figura 21: Rritja e kompanive bazuar në numrin e punonjësve (2014 – 2015)




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Nga kompanitë e anketuara duket se industria kimike është industri e dominuar nga gjinia mashkullore; ekziston një dallim i madhë në shkallën e punësimit ndërmjet burrave dhe grave në industrinë kimike. Mesatarisht, gratë përbëjnë vetëm 13% të numrit total të punonjësve gjatë periudhës 2013-2015 (Figura 22).

⁶ ASK (2015) <https://ask.rks-gov.net/ENG/labour-market/publications>


Figura 22: Struktura gjinore dhe numri mesatar i punonjësve (2013–2014)



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Shqiptarët përbëjnë pjesën më të madhe të numrit të gjithëmbarshtëm të punonjësve të kompanive të anketuara – 75% të fuqisë punëtore të përgjithshme të sektorit. Turqit dhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas përfaqësohen me 10% respektivisht 8% në fuqinë punëtore në industrinë kimike; pjesa e mbetur prej 7% janë goran dhe boshnjak (Figura 23).

Figura 23: Përbërja etnike e punonjësve




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kutiza 4: Rregulloret e tregut të punës

Kosova ka treg shumë fleksibil të punës me taksa të ulëta si dhe fleksibilitet sa i përket punësimit apo largimit të punëtorëve. Sistemi i shkallës së tatimit në të hyra personale është sistem tatimor progresiv me normë tatimi 0-10%. Përveç kësaj, vetëm kontributi pensional prej 5% të pagës totale paguhet nga punëdhënësi (derisa pjesa tjetër prej 5% të pagës paguhet nga punonjësit). Që nga viti 2011, Kosova ka pasur pagë minimale prej 179 Euro, apo 130 Euro për individët nën moshën 35 vjeçare. Marrëdhëniet e punësimit rregullohen me Ligjin e Punës (Nr. 03/L-212) i cili merr në konsideratë Konventat e ONP-së (ILO), Legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë të punës dhe ekonomisë së tregut. Që nga viti 2013, siguria dhe shëndeti në punë rregullohen me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Nr. 04/L-161).

Më shumë se tri të katërtat e të gjithë fuqisë punëtore në industrinë kimike përbëhen nga punonjës të moshës së mesme. Mesatarisht 19% janë punonjës në moshë të re në kompanitë e anketuara; vetëm 4% janë të grupmoshës mbi 51 vjeç (Figura 24).

Figura 24: Struktura e moshës së punonjësve




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

5.2. Aftësitë e fuqisë punëtore

Arsimi i mesëm është niveli më i lartë i arsimit i arritur për më shumë se 70% të fuqisë punëtore në kompanitë e angazhuara në prodhimin e produkteve kimike në Kosovë. Nuk është e çuditshme që një e pesta e punonjësve kanë përfunduar arsimin terciar. Aktivitetet thelbësore në sektor kërkojnë mbikëqyrje të përhershme nga personeli i trajnuar mirë dhe i arsimuar në shkenca kimike. Pjesa e mbetur prej 9% e punonjësve në kompanitë e anketuara kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (Figura 25).


Figura 25: Struktura e punonjësve sipas nivelit arsimor



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Rezultatet nga hulumtimi sugjerojnë që mungesa e punonjësve me arsimim apo aftësi adekuate është një prej sfidave kryesore me të cilën ballafaqohen aktualisht kompanitë në industrinë kimike. Përveç kësaj, punonjësit e kualifikuar dhe të diplomuarit nga universiteti shihen si të kushtueshëm nga 20% respektivisht 17.5% e të gjitha kompanive të anketuara. Në anën tjetër, 27.5% e kompanive kanë deklaruar që ka mungesë të të diplomuarve nga shkollat adekuate profesionale në tregun e punës në Kosovë. Këto gjetje sugjerojnë që ka mungesë të profileve përkatëse në industrinë kimike (Figura 26).

Figura 26: Perceptimi lidhur me koston dhe disponueshmërinë e punonjësve të kualifikuar dhe të arsimuar mirë




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

6. Asetet, investimet dhe inovacioni

6.1. Asetet

Shumica dërmuese e kompanive të anketuara kanë raportuar se i kanë në pronësi shumicën e asetëve, me një përqindje të vogël të tyre që i huazojnë disa nga asetet. Toka e shfrytëzuar është në pronësi të 60% të kompanive të anketuara, objektet nga 78% e tyre, ndërsa teknologjia që matet në bazë të makinerisë dhe pajisjeve është në tërësi në pronësi të tyre. Madhësia e kompanisë është në proporcion të drejtë me pronësinë e asetëve. (Figura 27).


Figura 27: Përqindja e asetëve në pronësi



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Të dhënat zbulojnë që kur bëhet fjalë për pronësinë e teknologjisë, nuk ka dallim ndërmjet bizneseve mikro dhe të vogla, pasi që të gjitha e kanë teknologjinë në pronësi të tyre. Megjithatë, madhësia e kompanisë është në proporcion të drejtë me pronësinë e asetëve. Krahësuar me mikro bizneset, bizneset e vogla kanë një pjesëmarrje prej 52% (48% nga mikro kompanitë) në pronësinë e objekteve dhe 54% (46% nga mikro kompanitë) në pronësinë e tokës (Figura 28).

Figura 28: Përqindja e asetëve në pronësi sipas madhësisë së kompanisë



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Vlera e të gjitha aseteve për kompani është raportuar të jetë në mes të minimumit prej 267,862 Euro dhe maksimumit prej 440,000 Euro. Në vitin 2013, vlera mesatare e të gjitha aseteve vlerësohej të ishte rreth 337,000 Euro, për t'u rritur në 389,080 Euro në vitin 2014. Kjo tregon një trend në rritje të këtij sektori. Siç është paraqitur në Tabelën 6, mesatarisht, pjesëmarrja e teknologjisë dhe tokës në asetet e përgjithshme ka rënë nga viti 2013 në vitin 2014, ndërkaq pjesëmarrja e objekteve në asetet e përgjithshme është rritur nga 30% në 40%. Kur shikohen bizneset mikro, rezultatet tregojnë një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes së teknologjisë së tyre në asetet e përgjithshme (rritje prej 16% në 53%) krahasuar me bizneset e vogla që kryesisht kanë rritur pjesëmarrjen e objekteve në asetet totale (Tabela 6). Këto gjetje sugjerojnë që në mes të viteve 2013 dhe 2014, mikro bizneset kanë investuar në zgjerimin e kapaciteteve të tyre përmes teknologjisë, ndërkaq bizneset e vogla i kanë zgjeruar objektet e tyre duke investuar në ndërtesa. Sidoqoftë, meqenëse shumica e kompanive të anketuara nuk e kanë raportuar vlerën e aseteve të tyre, rezultatet duhen të merren në konsideratë me kujdes.

Tabela 6: Pjesëmarrja e llojit të asetit në asetet e përgjithshme sipas madhësisë së kompanive

Madhësia e kompanisë	Mikro + E vogël		Mikro		E vogël	
Viti	2014	2013	2014	2013	2014	2013
Toka	35%	44%	29%	41%	34%	62%
Ndërtesat	40%	30%	17%	43%	41%	4%
Teknologjia	24%	26%	53%	16%	24%	34%


Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

6.2. Investimi dhe inovacioni

Sa i përket investimit të raportuar nga bizneset e anketuara, vetëm 23% kanë raportuar se kanë investuar në produkte apo shërbime të reja apo inovative. Madhësia e kompanisë duket se ka domethënie kur bëhet fjalë për investimet që lidhen me inovacionin, pasi që vetëm 22% e kompanive që kanë bërë investime janë nga bizneset mikro krahasuar me bizneset e vogla që kanë një pjesëmarrje prej 78%. Të dhënat tregojnë që madhësia e bizneseve është e lidhur pozitivisht me investimet në produkte e shërbime të reja. Në vitin 2014, mesatarja e investimeve të përgjithshme në produkte apo shërbime të reja ishte rreth 44,000 Euro. Për të financuar këto investime, dërgesat nga diaspora/remitencat si burim financash përdoren nga vetëm 5% të kompanive përkatëse.

Investimet në pajisje të reja dhe avancimin e linjave të prodhimit janë bërë nga shumica e kompanive (78%), ndërkaq investimet në kapitalin qarkullues nga një numër më i vogël i kompanive (22%). Për më tepër, vetëm rreth 15% e kompanive (67% prej të cilave janë të vogla) kanë raportuar se kanë futur metoda të reja të prodhimit, marketingut apo organizimit të biznesit gjatë vitit 2014. Siç është treguar në Figurën 29, nga kompanitë që kanë raportuar se kanë aplikuar së paku një nga tri llojet e inovacionit, 67% kanë bërë inovacion të procesit, 33% inovacion në marketing, ndërsa asnjë nuk është angazhuar në inovacion organizativ.


Figura 29: Përqindja e kompanive inovative sipas llojit të inovacionit



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kompanitë e anketuara nga industria kimike kryesisht kanë përmirësuar dizajnin e produkteve të tyre si formë e inovacionit në marketing, dhe kanë investuar në vegla dhe pajisje të nevojshme për inovacion në proces. Duke marrë në konsideratë të gjitha llojet e inovacionit të raportuara nga kompanitë, duke përfshirë investimet në produkte dhe shërbime të reja, të dhënat tregojnë se rreth 33% të kompanive janë angazhuar në së paku një aktivitet që ndërlidhet me inovacion në vitin 2014.

Figura 30: "A mendoni se mbrojtja e të drejtave pronësore e pengon zhvillimin e biznesit tuaj"



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kur janë pyetur lidhur me mbrojtjen e të drejtave pronësore në Kosovë, një përqindje e vogël e kompanive të anketuara konsiderojnë që sistemi aktual është dekurajues. Siç është treguar në figurën më lartë, 35% e kompanive të anketuara ndiejnë që mbrojtja e të drejtave pronësore ndikon negativisht në sektor, qoftë në lidhje me zhvillimin e produkteve/shërbimeve të reja (22.5% e kompanive) apo në transferimin e aktiviteteve të kompanive ndërkombëtare (12.5% e kompanive).

Tabela 7: Regjistrimi i patentës dhe perceptimet për procedurat e regjistrimit

	% e të gjitha kompanive	% e kompanive që mbajnë patentë
Ka regjistruar patentë	15%	-
Vështirësitë në regjistrimin e patentës pengojnë zhvillimin e biznesit	5%	33%

Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Për më tepër, të dhënat nga hulumtimi tregojnë që 15% e kompanive të anketuara në industrinë kimike mbajnë patentë të regjistruar (Tabela 7). Në anën tjetër, disa nga kompanitë konsiderojnë se procedurat për regjistrimin e patentave po e pengojnë zhvillimin e biznesit të tyre (5% e të gjitha kompanive, apo 33% e bartësve të patentave).

Kutiza 5: Prona industriale dhe patentimi në Kosovë

Markat tregtare rregullohen me Ligjin për Markat Tregtare (Nr. 02/L-54)). Markat tregtare regjistrohen tek Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës. Zotëuesi i markës tregtare, pas regjistrimit, do të ketë të drejtën ekskluzive në lidhje me mallrat apo/dhe shërbimet që mbulohen me atë regjistrim. Në veçanti këto të drejta kanë të bëjnë me: përdorimin e markës tregtare, autorizimin e një personi tjetër që të përdorë markën tregtare apo të marrë kompensim ligjor për shkelje të markës tregtare. Marka tregtare regjistrohet për një periudhë prej 10 vitesh dhe mund të vazhdohet për kohë të pakufizuar.

Dizajni Industrial rregullohet me Ligjin për Dizajnin Industrial (Nr. 04/L-038). Ai mbrohet me ligj deri në momentin kur është një inovacion dhe ka karakter specifik. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vite dhe mund të zgjatet deri në maksimum 25 vjet.

Patentimi rregullohet me Ligjin për Patentim (Nr.2004/49). Një zbulim do të jetë i patentueshëm nëse është i ri, përfshinë një hap inventiv dhe është i aplikueshëm industrialisht. E drejta e patentimit jepet për kohëzgjatjen prej 20 vite.


Standardizimi rregullohet me Ligjin për Standardizimin (Nr. 03/L-144). Certifikimi i produkteve, përpunimit, shërbimeve, cilësisë dhe sistemeve të personelit rregullohen me ligjin për Standardizim, dhe institucioni përgjegjës për lëshimin, aplikimin dhe përcaktimin e standardeve është Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS).

7. Mjedisi biznesor

7.1. Barrierat në zhvillimin e biznesit: perceptimet biznesore

Hulumtimi ka vlerësuar shkallën e kënaqësisë apo pakënaqësisë së kompanive në industrinë kimike lidhur me mjedisin biznesor në Kosovë. Nga kompanitë e anketuara ishte kërkuar që të vlerësojnë, në shkallën nga 0 deri në 17 – ku 0 paraqet vlerën minimale dhe 17 vlerën maksimale – nëse një çështje apo institucion i caktuar ka paraqitur pengesë apo barrierë në operimet e tyre biznesore. Pikët mesatare për secilën nga çështjet janë paraqitur në formë grafike në Figurën 31.

Figura 31: Barrierat biznesore (pikët mesatare në shkallën nga 0-17 – 0 minimalja, 17 maksimalja)



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Sipas rezultateve të hulumtimit, kompanitë në industrinë kimike duket se në përgjithësi janë të kënaqura me procedurat për regjistrimin e biznesit, me infrastrukturën lokale, si dhe qasjen në tokë. Rezultati mesatar për këto çështje është rreth 6 pikë të shkallës – që është konsiderueshëm më e ulët se vlera mesatare prej 8.6. Renditja e ulët e barrierës “regjistrimi i biznesit” nuk është e papritur. Pjesërisht ka të bëjë me themelimin, kohëve të fundit, të pikave të regjistrimit të ashtuquajtura “one-stop-shops” në 28 komuna të Kosovës, të cilat janë të autorizuar që në mënyrë rutinore të bëjnë regjistrimin e bizneseve dhe të lëshojnë numra fiskal për një periudhë më të shkurtër kohore. Kjo gjithashtu mund t’i atribuohet reformave të ndërmarra në vitin 2013 që çuan në: largimin e kërkesës për kapital minimal dhe largimin e taksës për regjistrim biznesi, largimin e kërkesave për validim të projekteve ndërtimore dhe reduktimin e taksës për leje ndërtimore, dhe në fund krijimit të sistemit të noterëve që i kontribuon kombinimit të procedurave për legalizimin e marrëveshjeve të shitjes dhe blerjes. Infrastruktura në anën tjetër ka qenë pjesë e investimeve dhe donacioneve të mëdha lokale, qendrore dhe ndërkombëtare. Për tri vitet e fundit, institucionet qendrore të Kosovës si dhe komunat lokale kanë filluar me investime të mëdha, që përfshijnë mesatarisht rreth 22% të buxhetit të përgjithshëm publik (Riinvest, 2015)⁷.


Kutiza 6: Institucionet relevante

- ✓ Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (regjistrim biznesi), <http://www.arbk.org/>
- ✓ Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (informim për investitorë të huaj për fillimin e biznesit, mundësitë për investime, partnerët potencial biznesorë, etj.), <http://www.invest-ks.org/>
- ✓ Administrata Tatimore e Kosovës (pagesa e taksave), <http://www.atk-ks.org/>
- ✓ Shitoret “të gjitha në një vend” në komuna (burime informatash dhe shërbime këshilluese)
- ✓ Doganat e Kosovës (informata për taksat doganore dhe procedurat), <https://dogana.rks-gov.net>
- ✓ Shoqata e Bizneseve (rrjetet biznesore, panaiet, misionet tregtare, avokimi, etj.): Oda Ekonomike; Oda Ekonomike Amerikane; Aleanca Kosovare e Biznesit.

Një tjetër çështje për të cilën pakënaqësia e kompanive është mjaft e lartë është niveli i tatimeve. Kjo çështje ka marrë një vlerësim mesatar prej 9.7 pikë. Duke hulumtuar më tej këtë barrierë, siç shihet në Figurën 32, shumica e kompanive mikro dhe të vogla të këtij sektori e shohin nivelin e tatimit ose si shumë të lartë (12.5%) ose të lartë (35%). Një pjesë shumë e vogël mendojnë që tatimet janë të ulëta apo shumë të ulëta (5% gjithsej). Pothuajse gjysma e të anketuarve kanë mendim neutral për këtë çështje.

⁷ Riinvest (2015) në dispozicion në http://riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Business_Climate_in_Kosovo1421852590.pdf

Figura 32: Si do të përshkruanit më së miri nivelin e tatimeve?




Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Kutiza 7: Lista e lejeve dhe certifikatave relevante

- ✓ *Certifikata Biznesore*
- ✓ *Regjistrimi në Administratën Tatimore të Kosovës*
- ✓ *Regjistrimi i punonjësve për skemën pensionale në Administratën Tatimore*
- ✓ *Leja mjedisore*
- ✓ *Leje për mbrojtjen nga zjarri*
- ✓ *Leje për ujin*
- ✓ *Leje ndërtimi*
- ✓ *Kyçje në rrjetin elektrik*

Lista e barrierave gjithashtu tregon se ekziston një nivel i lartë i pakënaqësisë me efikasitetin e Administratës Tatimore (rezultati mesatar 9.0) dhe të Doganave (9.1). Pakënaqësia më e lartë me Doganat sesa me Administratën Tatimore është konfirmuar gjithashtu nga Figura 33.

Figura 33: "Si do të vlerësonit efikasitetin e Administratës Tatimore dhe Doganave?"



Burimi: Hulumtimi nga UNDP-ja, 2015

Edhe pse shumica e kompanive të intervistuar në industrinë kimike kanë perceptim neutral lidhur me efikasitetin e të dyja institucioneve, ekziston qartazi një pakënaqësi sa i përket efikasitetit më të ulët të Administratës Doganore. Rreth 18% e respondentëve besojnë që Doganat janë joefikase.

8. Konkludimet

Industria kimike është një industri relativisht e re dhe gjithnjë në rritje në Kosovë. Pothuajse gjysma e kompanive aktuale janë krijuar pothuajse gjatë tri viteve të fundit; rreth një e treta e kompanive janë të përqendruara në rajonin e Prishtinës. Shpërndarje e ngjashme gjeografike shihet edhe tek kompanitë e sapokrijuara. Sipas të dhënave nga ARBK, rreth 36% e kompanive të reja janë themeluar në rajonin e Prishtinës. Kompanitë në industrinë kimike janë aktive kryesisht në tre nën-sektorët në vijim: prodhimin e ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrës për printim dhe rrëshirave, (ii) prodhimin e sapunit dhe detergjenteve, preparateve për pastrim dhe lustrim, dhe (iii) prodhimin e ngjitësit. Shumica e tyre janë ndërmarrje mikro; ndërmarrjet e vogla dhe të mesme paraqesin 16% të kompanive në industrinë kimike.

Edhe pse industria kimike nuk është intensive sa i përket punësimit, punësimi në këtë industri është vazhdimisht në rritje, edhe pse rritja është modeste. Prodhuesit e ngjitësit kanë përjetuar rritjen më të lartë sa i përket punësimit. Sidoqoftë, të dhënat nga hulumtimi tregojnë që gratë janë në nivel të ulët të përfaqësimit në këtë industri; gratë përbëjnë vetëm 13% të mbarë fuqisë punëtore në këtë industri. Arsimi i mesëm është niveli më i lartë i arsimit për më shumë se 70% të fuqisë punëtore në kompanitë e angazhuara në prodhimin e produkteve kimike në Kosovë. Në anën tjetër pothuajse 20% e tyre kanë përfunduar arsimin terciar. Megjithatë, mungesa e punonjësve me arsim apo aftësi adekuate është një ndër sfidat me të cilën kompanitë në industrinë kimike ballafaqohen aktualisht.

Prodhimi mesatar i raportuar, si dhe shfrytëzimi i kapaciteteve, gjithashtu tregojnë që performanca e përgjithshme e industrisë kimike është duke u përmirësuar. Shumica dërmuese e kompanive kanë filluar të eksportojnë pas vitit 2010; vetëm 30% e kompanive ishin të angazhuara në aktivitete eksportuese në vitin 2014. Sidoqoftë, ekziston një qëndrim pozitiv sa i përket eksportit tek kompanitë që nuk eksportojnë, pasi që një e treta e tyre janë shprehur se kanë plane që të eksportojnë në të ardhmen. Për më tepër, frika që kompanitë do të përballen me shumë sfida dhe pengesa gjithashtu e pengon eksportin në këtë industri. Në anën tjetër, produktet e ndërmjetme dhe lënda e parë e përdorur nga kompanitë në industrinë kimike kryesisht importohen, kryesisht nga vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA.

Procedurat doganore dhe standardet ndërkombëtare të cilësisë konsiderohen barrierat kryesore për eksport, ndërkaq mundësitë e kufizuara për të krijuar lidhje me blerës ndërkombëtarë dhe kostot e transportit konsiderohen si barriera e dytë kryesore për eksport.

Vetëm një përqindje e vogël e kompanive të anketuara e konsiderojnë regjistrimin e patentës si pengesë në zhvillimin e biznesit. Në anën tjetër, kompanitë në industrinë kimike duket se në përgjithësi janë të kënaqura me procedurat për regjistrimin e biznesit, infrastrukturën lokale dhe qasjen në toka.

Barrierat kryesore në industrinë kimike duket se lidhen me nivelin e lartë të korrupsionit, si dhe me çmimin dhe furnizimin me energji elektrike. Një çështje tjetër për të cilën pakënaqësia e kompanive është mjaft e lartë është niveli i tatimeve. Shumica e kompanive mikro dhe të vogla e shohin nivelin e tatimeve si shumë të lartë. Edhe pse shumica e kompanive të anketuara në industrinë kimike kanë perceptim neutral lidhur me efikasitetin e Administratën Tatimore dhe atë Doganore, ekziston një pakënaqësi e qartë sa i përket efikasitetit të Administratës Doganore.

Referencat

ARBK, 2015. Baza e të dhënave e bizneseve të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës, 2015. Baza e të dhënave e bizneseve të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Hulumtimi nga UNDP, 2015. Hulumtimi i kompanive në Industrinë Kimike në Kosovë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015. Rezultatet e Hulumtimit të Fuqisë Punëtore në Kosovë, 2014.

Instituti Riinvest, 2015. Klima biznesore në Kosovë: Këndvështrimi ndër-rajonal.



MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

www.mti-ks.org